

**Projektligj**  
**“ Për referendumet vendore”**

Mbeshtetur në nenin 2, pika 1 e 2 dhe nenin 108, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të Këshillit të Ministrave

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe objekti**

1. Ky ligj përcakton parimet, rregullat dhe procedurat në bazë të të cilave fillohet dhe zhvillohet një referendum vendor, në përputhje me parimet kushtetuese dhe Kodin e praktikave të mira për referendume të Komisionit të Europian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecies).

2. Referendumi vendor ka për qëllim realizimin e të drejtës kushtetuese të shtetasve shqiptar për ushtrimin e parimit të demokracisë direkte për vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve të vetëqeverisje lokale.

3. Në këtë ligj janë objekt i rregullimit:

- (a) Llojet e referendumit vendor dhe objekti i tij
- (b) Kufizimet në ushtrimin e të drejtës për referendum vendor, vlefshmëria e tekstit të referendumit vendor, garancite dhe detyrimi për informim.
- (c) Organizimi dhe funksioni i administratës dhe komisioneve përgjegjëse për administrimin e referendumit vendor.
- (d) Nismëtarët për një referendum vendore, niveli i njësisë vendore ku mund të zhvillohet një referendum vendor.
- (e) Procedurat për zhvillimin e referendumit vendor.
- (f) Fushata për informim dhe financimi i referendumit vendor
- (g) Votimi, nxjerrja e rezultatit dhe detyrimi për zbatimin e tij

**Neni 2**

**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Formular tip” është formulari me të cilin KQRV pajis nismëtarët e referendumit vendor për të marr firmat e shtetasve që mbështetin inisiativën për referendum sipas rregullave dhe kërkesave të përcaktuar në këtë ligj.

2. “Fushatë informuese” është aktiviteti që kryhet për të informuar qytetarët për çështjen/problemin për të cilin është kërkuar të bëhet referendum vendor

3. “Grup nismëtar” është një grup qytetarësh, me të drejtë vote, që marrin inisiativën, hartojnë dhe paraqesin tek KQRV-ja, kërkesën për referendum vendor sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

4. “KQRV” është Komisioni Qytetar për Referendumin Vendor, organi me i lartë në nivelin e bashkisë, që ngrihet sipas rregullit të përcaktuar në këtë ligj dhe që është i ngarkuar me detyrën e administrimit të referendumit vendor, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

5. “KQRVQ” është Komisioni Qytetar i Qarkut për Referendumin Vendor që ngrihet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

6. “KQQV” është Komisioni qytetar që administron procesin e votimit në qendrën e votimit, që ngrihet dhe funksionon në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

7. "Lista e votuese" janë dokumentat zyrtare të regjistrimit të shtetasve, banorë rezidentë të njësisë vendore ku kryhet referendumi vendor, që hartohen mbështetur në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile ose nga vendime gjyqësore.
8. "Njësi vendore" është njësi vendore, njësi administrative, bashki, qark, ku mund të zhvillohet referendumi vendor
9. "Referendum vendor" është referendumi, që zhvillohet sipas pikës 4 të nenit 108 të Kushtetutës.
10. "Referendum konsultues" është referendumi rezultati i tij nuk është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga autoritet dhe organet e qeverisjes vendore
11. "Referendum vendimmarrës" është referendumi rezultati i të cilit është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga autoritet dhe organet e qeverisjes vendore
12. "Referendum abrogues" është referendumi rezultati i të cilit çfuqizon një vendim të organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore
13. "Rezultat përfundimtar i referendumit" është rezultati i shpalluar nga KQRV/KQRVQ në përputhje me këtë ligj dhe që përmban numrin e votave të vlefshme për secilën nga dy alternativat, "po" ose "jo", të pyetjes të referendumit vendor.
14. "Subjekt që ushtron të drejtën e votës në referendum vendor" janë shtetas shqiptarë ose banorë në njësinë vendore përkatëse me shtetësi jo shqiptare që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj për të ushtruar të drejtën për të votuar në një referendum vendor.
15. "Qytetar" është çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë me të drejtë vote, në kuptim të nenit 45 të Kushtetutës së RSH.
16. "Votues i madh" është shtetasi me të drejtë vote, i zgjedhur nga Këshilli komunitar i lagjes, Kryesia fashatit dhe nga antarësia e Keshillit bashkiak sipas rregullit të përcaktuar në këtë ligj, i cili do të zgjedh antarët e Komisioni Qytetar për Referendumin Vendor

### **Neni 3**

#### **Kuptimi i referendumit vendor**

1. Referendumi vendor është formë e ushtrimit të të drejtës së qytetarve, antarë të komunitetit në një njësi të qeverisjes vendore, për të marr pjesë direkt në zgjidhjen e çështjeve ose problemeve lokale dhe që janë nën juridiksionin e njësisë të vetëqeverisjes vendore.
2. Vendimi i miratuar nëpërmjet një referendumi lokal vendimmarrës ose abrogues ka epërsi mbi vendimet që marrin organet e zgjedhura të qeverisjes vendore dhe që nuk pajtohen me të. Për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm ratifikimi nga organe shtetërore. Ai nuk mund të shfuqizohet dhe as të ndryshohet përveç se, vetëm sipas procedurës sipas së cilës është marr.

### **Neni 4**

#### **Llojet e referendumit vendor**

1. Referendumi vendor mund të jetë:
  - a) referendum konsultues
  - b) referendum vendimarrës
  - c) referendum për shfuqizimin e një vendimi të organeve të qeverisjes vendore
2. Referendumet konsultuese mund të thërriten prej organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore si pjesë e procesit që paraprind vendimmarrjen e tyre për një çështje ose problem të rëndësishëm që lidhet me kushtet e bashkëjetesës lokale, mirëadministrimin, përdorimin e qëndrueshme të mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të njësisë vendore përkatëse.
3. Inisiativat qytetare për referendum vendor, si rregull thërriten për të zhvilluar një referendum vendor vendimmarrës dhe /ose për të shfuqizuar vendimin e një organi të qeverisjes vendore.

### **Neni 5**

#### **Sigurimi dhe besueshmëria procedurale**

1. Për referendumet vendore zbatohen të njëjtat parime të përgjithshme për sigurinë dhe

besueshmërinë procedurale, si ato të përcaktuara në legjislacionin zgjedhor në Republikën e Shqipërisë

2. Organizimi dhe administrimi i referendumit vendor duhet të bëhet nga komisione të pavarura, pa pjesëmarrjen në to të përfaqësuesve të partive politike

3. Procedurat sipas të cilave zhvillohet një referendum vendor duhet të sigurojnë respektimin e të drejtave themelore të njeriut, barazinë në të drejtën dhe lirinë e shprehjes, lirinë për t'u grumbulluar dhe përdorur në mënyrë të barabartë hapsirat publike, të drejtën për t'u informuar dhe ankimuar në mënyrë të barabartë. Autoritetet dhe institucionet publike që ky ligj i ngarkon me përgjegjësi për organizimin dhe zhvillimin e referendumit vendor dhe organet e vetëqeverisjes vendore duhet të krijojnë të gjithë kushtet e nevojshme për zhvillimin e procedurave të përcaktuara në këtë ligj, në përputhje dhe në zbatim të kompetencave ligjore të tyre në fuqi.

#### **Neni 6**

##### **Kufizime në ushtrimin e referendumit vendor**

1. Asnjë referendum vendor nuk mund të zhvillohet datën e zgjedhjeve të përgjithshme ose vendore.

2. Nuk mund të zhvillohet referendum vendor gjatë periudhës nga tre muaj para përfundimit të mandatit të organeve të qeverisjes vendore, deri tre muaj pas mbledhjes së parë të këshillave vendore.

3. Kur në një njësi të qeverisjes vendore shpallen zgjedhje të parakohshme, procedura për zhvillimin e referendumit vendor në atë njësi pezullohet deri pasi të kenë kaluar tre muaj nga fillimi i mandatit të organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore.

4. Nuk ka kufizim për numrin e referendumeve vendore që mund të zhvillohen brënda një vit, në një njësi të qeverisjes vendore. Në rastet kur kërkesa për referendum vendor behet kur kane filluar procedurat për referendum kushtetues, referendum të përgjithshëm ose, në njësinë vendore perkatese kane filluar procedurat e një referendumi vendor, kërkesa për të nuk mund të shqyrtohet pa përfunduar referendumi për të cilin kanë filluar procedurat për kryerjen e tij.

5. Zhvillimi i referendumit nuk kufizohet nga koha që nevojitet për plotësimin e procedurave të përcaktuara për të. Vetëm në rastin kur objekt i referendumit është një çështje vendore për të cilën, në ligjin për vetëqeverisjen vendore ose rregulloren e punës së organeve të qeverisjes vendore parashikohen afate kohore për trajtimin e tyre, zhvillimi i referendumit kushtezohet nga respektimi i këtyre afateve.

6. Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet në të njëjtën njësi të qeverisjes vendore, pa kaluar një vit nga zhvillimi i tij.

#### **Neni 7**

##### **Vlefshmëria e tekstit të referendumit vendor**

1. Teksti i një referendumi vendor duhet të përcaktojë qartësisht dhe në mënyrë konkrete, pa krijuar mundësi për keqkuptim, çështjen për të cilën kerkohet realizohet referendumi. Teksti nuk mund dhe nuk duhet të përmbajë çështje parimore dhe formulime të përgjithshme.

2. Pjesët përbërëse të një teksti për referendum vendor, duhet të bashkërenditen sipas një rendi të qartë logjik, duhet të jenë të kuptueshme, koherente dhe lehtësisht të lexueshme si informacion që lidhet me çështje ose probleme lokale që janë nën juridiksionin dhe autoritetin e organeve të vetëqeverisjes vendore.

3. Teksti në një referendum vendor duhet të formulohet në trajtën e një pyetje e cila:

a) duhet të jetë konkrete, e qartë dhe direkte.

b) nuk duhet të krijojë mundësi për keqkuptime.

c) nuk duhet të formulohet në formë tillë që të ndikojë në dhënien e përgjigjes.

d) përmbajtja e saj nuk duhet të ketë asnjë lidhje direkte ose indirekte me probleme të amendimit të kushtetutes dhe me ndryshime në ligje.

4. Pyetja në një referendum vendor duhet të formulohet në mënyrë të tillë që:

a) përgjigja e saj të jete një alternativë zgjidhje qartësisht e lidhur me problemin lokal që trajtohet në referendum

b) efektet që sjell zbatimi i përgjigjes së pyetjes duhet të kufizohen vetëm në njësinë vendore në të cilën zhvillohet referendumi vendor.

c) përgjigja e pyetjes të jete alternativë zgjidhje për problemin lokal e mundshme për t'u zbatuar nga organeve të qeverisjes vendore

5. Teksti i një referendumi vendor nuk duhet të bjerë ndesh në asnjë rast me kushtetutën, me parimet kryesore demokratike, të drejtat e njeriut dhe shtetit të së drejtës si dhe me përcaktimet e shprehura në kuadrin rregullator dhe legjislativ ndërkombëtar, të njohur dhe pranuar nga shteti shqiptar.

## **Neni 8**

### **Garancitë dhe detyrimi për informim**

1. Organe e qeverisjes vendore në çdo rast duhet të jenë mbështetëse dhe kontribuese për realizimin e të drejtës së qytetarëve për pjesëmarrje në referendum vendor. Ato duhet të jenë garante për zhvillimin normal të procesit të referendumit.

2. Organet e qeverisjes vendore dhe institucionet ligjzbatuese që ushtrojnë aktivitetin në njësinë e qeverisjes vendore ku zhvillohen referendumi lokal janë përgjegjëse dhe kanë detyrimin për krijimin e mjedisit social dhe rendit për zhvillimin normal të të gjithë procedurave që parashikohen për një referendum vendor.

3. Autoritetet kompetente dhe përgjegjëse për realizimin e procedurës së referendumit vendor, duhet t'i ofrojnë zgjedhësve, në mënyrë të vazhdueshme, një informacion objektiv, të qartë, të plotë, të saktë dhe shpjegues për problemin që trajtohet në referendum. Nëpërmjet nje materiali shpjegues ato duhet të informojnë qytetaret për:

a) llojin e referendumit vendor, objektin, çështjen, problemin lokal për të cilin kerkohet të zhvillohet referendumi;

b) arsyen pse kerkohet të zhvillohet referendumi;

c) pikëpamjet mbështetëse dhe kundërshtuese për të.

4. Informimi i qytetarëve duhet të bëhet të paktën një muaj para zhvillimit të referendumit. Për këtë qëllim, mund të përdoren pa detyrim financiar, mediat lokale të shkruara dhe elektronike, mjetet dhe kanalet e tjera lokale të komunikimit dhe informimit të publikut, që veprojnë në njësinë vendore ku do të zhvillohet referendumi vendor.

5. Komisioni Qytetar për Referendumin Vendor duhet të organizojë dhe zhvillojë fushatën edukuese për të drejtat dhe detyrat, procedurat dhe rregullat që duhet të zbatohet nga qytetaret kur votojnë në një referendum vendor

## **Neni 9**

### **Paanësia e autoriteteve**

1. Organet e qeverisjes vendore dhe autoritetet kompetente nuk duhet të kryejnë asnjë veprim, nuk duhet të organizojnë dhe as të mbështetin asnjë aktivitet i cili mund të ndikojë në rezultatin e referendumit vendor. Ato nuk mund të shprehen dhe as të shfaqen në favor të asnjërën prej palëve që mbrojnë qëndrime të ndryshme gjatë referendumit.

2. Ndalohet përdorimi i fondeve publike për qëllime propagandistike për referendumin vendor gjatë të gjithë zhvillimit të fushatës informuese për referendumin vendor.

5. Organet e qeverisjes vendore duhet të sigurojnë, pa pagesë, hapësirën e duhur, mjediset publike për mbledhjen e firmave dhe/ose për kryerjen e aspekteve të tjera procedurale për referendumin vendor, duke respektuar përherë parimin e barazisë.

**Kreu II**  
**AUTORITETET PËR ORGANIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E REFERENDUMIT VENDOR**

**Neni 10**

**Komisioni qytetar për referendumin vendor (KQRV)/(KQRVQ)**

1. Për organizimin dhe administrimin e referendumeve vendore në çdo bashki ngrihet Komisioni Qytetar për Referendumin Vendor (KQRV).
  2. Për organizimin dhe administrimin e referendumeve vendore që zhvillohen në nivel qarku, në çdo qark ngrihet Komisioni Qytetar për Referendumet Vendore të Qarkut (KQRVQ)
  2. KQRV / KQRVQ është komision i përhershëm që aktivizohet sa herë që ka inisiativa për referendum vendor në njësinë përkatëse vendore.
  3. KQRV përbëhet nga 7 (shtatë) antarë, të cilët zgjidhen jo më vonë se tre muaj nga konstituimi i organeve të zgjedhura për vetëqeverisjen vendore.
  4. Për zgjedhjen e antarëve të KQRV-se ndiqet procedura si në vijim:
    - a) Këshilli bashkiak, jo më vonë se një muaj nga konstituimi i tij, shpall, me vendim, hapjen e procesin të kandidimit për antarë të KQRV-së. Në njoftim paraqiten kërkesat dhe cilësitë që duhet të plotësojë qytetari që kandidon dhe afati deri kur pranohen kandidaturat.
    - b) Për verifikimin e plotesimit formal të kërkesave dhe cilësive që duhet të zotrojnë kandidatet, Këshilli bashkiak ngre, me vendim, komisionin e verifikimit të kandidaturave. Komisioni përbëhet nga 5 antarë, që zgjidhen nga antarësia e Këshillit bashkiak, duke respektuar proporcionalisht, përfaqësues të ndryshëm të bashkisë, përfaqësues politik në Këshill.
    - c) Me shpalljen e procesit të kandidimit për antar të KQRV-së, Këshilli bashkiak ju kërkon Këshillave komunitar të lagjeve dhe Kryesive të fshatrave, të zgjedhin një përfaqësues të tyre, që do të ketë cilësinë e "votuesit të madh" dhe që do të zgjedh antarët e KQRV-së.
    - d) Pas përfundimit të verifikimit të dokumentacionit të kandidimit, Këshilli bashkiak ju dërgon votuesve të mëdhenjë, listën e kandidatëve për antarë të KQRV-së, së bashku me informacionin për secilin prej tyre.
    - e) Kryetari i Këshillit bashkiak organizon procesin e votimit për antarë të KQRV-se. Votimi zhvillohet në sallën e Mbledhjeve të Këshillit bashkiak, një ditë të diele, jo më vonë se dy jave pas hartimit të listës përfundimtare të kandidatëve. Procesi i votimit, administrohet nga Komisioni i verifikimit të kandidaturave.
- Për antarë të KQRV votojnë votuesit e mëdhenjë dhe një përfaqësues i secilës force politike që ka antarë në Këshillin bashkiak. Ky përfaqësues duhet të pajiset paraprakisht me vendimin mandatues i votuesit të madh, nga forca politike përkatëse. Çdo votues i madh ka të drejtë të zgjedh shtatë antarë, nga lista e kandidatëve.
- Antarë të KQRV-së shpallen kandidatët që, në bazë të votave të fituara, renditen në shtatë vendet e para. Në rastin e kandidatëve me vota të barabarta, zgjedhja bëhet me short.
5. KQRVQ përbëhet nga 7 (shtatë) antarë, të cilët zgjidhen, me votim të fshehtë nga antarët e KQRV-ve të bashkive që bëjnë pjesë në qarkun përkatës. Përfaqësimi me antarë në KQRVQ i çdo bashkie të qarkut duhet të jetë proporcional me përqindjen që zënë banorët, me të drejtë vote, të bashkisë përkatëse, në listën e përgjithshme të zgjedhësve të qarkut. Sekretari i KQRVQ përzgjidhet, me short, një prej sekretarve të KQRV-ve të bashkive që bëjnë pjesë në qarkun përkatës. Kryetari i këshillit të qarkut është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të antarëve të KQRVQ-së

**Neni 11**

**Kritere për antarë të KQRV-së**

1. Anëtar i KQRV-së mund të zgjidhet çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote dhe që plotëson kërkesat e këtij neni.

2. Anëtari i KQRV-së duhet të plotësojë këto kushte:
- a) të gëzojë të drejtë për te votuar;
  - b) të ketë arsimin e lartë;
  - c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formes se prerë për kryerjen e nje vepre penale;
  - d) të mos ketë qenë anëtar ndonjë partie politike gjatë 5 viteve të fundit;
  - e) të mos jetë larguar nga administrata publike për shkelje të ligjit;
  - f) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore në procese zgjedhore.
3. Antari i KQRV-se duhet të jetë votues i rregjistruar në listën e zgjedhësve të bashkisë përkatëse dhe të jetë me banim të përhershëm në këtë bashki.

#### **Neni 12**

##### **Mandati i antarit te KQRV-se**

1. Antari i KQRV-se zgjidhet me një mandat 4 vjecare, të përsëritshëm.
2. Mandati i antarit te KQRV-se ndërpritet kur:
  - a) me veprim ose mosveprim e tij cënon veprimtarinë e KQRV-së për përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha aspekteve që kanë të bëjnë me referendumin vendor, si dhe me shpalljen e rezultatit të tij;
  - b) jep dorheqjen.

Vendimi për nderprerjen e mandatit të antarit te KQRV-se merret mbi bazën e propozimit të 2/3 të antarve të tij, prej Këshillit bashkiak.

Vakanca e krijuar plotësohet me kandidatin e rradhës në listën e renditur sipas votave të fituara. Kur kjo listë shterron, Këshilli bashkiak organizon procesin e zgjedhjes së antarit te KQRV-se, sipas procedurave të parashikuara në nenin 10.

#### **Neni 13**

##### **Kryetari dhe nënkryetari i KQRV-së**

Në mbledhjen e parë të tij KQRV-ja zgjedh Kyetarin dhe nënkryetarin. Kryetar zgjidhet antari me moshë më të madhe. Nënkryetari zgjidhet, me shumicën e cilësuar të votave të antarve të KQRV-së.

#### **Neni 14**

##### **Detyrat e Kryetarit dhe nënkryetarit të KQRV-së**

1. Kryetari i KQRV-së drejton mbledhjet e KQRV-së dhe përfaqëson KQRV-në në marrëdhënie me institucionet e tjera;
2. Zëvendëskryetari i KQRV-së kryen detyrat e Kryetarit në mungesë të tij.

#### **Neni 15**

##### **Sekretari i KQRV-së**

Sekretari i KQRV-së përzgjidhet, me short, nga trupa gjyqësore e gjykatës administrative te shkalles se pare, në juridiksionin e të cilës është njësia vendore, bashkia përkatëse.

#### **Neni 16**

##### **Detyrat e sekretarit te KQRV-së**

Përgatit mbledhjet e KQRV-së, protokollon kërkesat dhe ankesat që i drejtohen KQRV-së, administron dhe kujdeset për ruajtjen e dokumentacionit te KQRV-së

#### **Neni 17**

##### **Mbledhja dhe vendimmarrja e KQRV-se**

1. Mbledhja e KQRV-se kërkon pjesëmarrjen e jo më pak se 2/3 të antarëve të tij.

2. Vendimet e KQRV-se miratohen me shumicën e thjeshtë të antarëve pjesëmarrës në mbledhje.

### **Neni 18** **Detyrat e KQRV-se**

1. KQRV-ja përgjigjet për organizimin dhe zhvillimin e referendumit vendor në njësinë vendore përkatëse. Ai ka detyrë:

- a) Të administrojë gjithë procesin e zhvillimit të referendumit vendor, në përputhje me dispozitat e këtij ligjin dhe, për aq sa është e mundur dhe e nevojshme në përputhje me dispozitat përkatëse të parashikuara në Kodin zgjedhor për administrimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
- b) Të përgatit fletën e votimit për referendumin vendor.
- c) Të afishojë në vend të dukshëm listat përfundimtare të votueseve.
- d) Të lehtësojë procesin e informimit të publikut për referendumin vendor.
- e) Të shpërndajë në qendrat e votimit materialet për votim.
- f) Të marr në dorëzim materialet e votimit dhe kutitë e votimit.
- g) Të përgatit tabelen përfundimtare me rezultatet e qendrave të votimit dhe të shpall rezultatin e referendumit.

2. KQRV-ja ngre, me vendim, Komisionet Qytetare për qendrat e votimit për referendumin vendor.

3. KQRV-ja ka të drejten për caktimin e datës kur do të zhvillohet referendumi vendor.

4. Kur në njësinë vendore zhvillohet referendumi vendor, KQRV-ja punon me kohe të plote, duke filluar nga dita kur paraqitet kërkesa për referendumi dhe deri në shpalljen e vendimit përfundimtar për rezultatin e referendumit. Antarët dhe sekretari i KQRV-se shpërblehen financiarisht për punën që bëjnë për organizimin dhe zhvillimin e referendumit vendor. Masa e këtij shpërblimi vendoset nga Këshilli bashkiak i bashkisë ku zhvillohet referendumi vendor. Kur referendumi zhvillohet në nivel qarku, masa e shpërblimit të antarëve të dhe KQRV-ve KQRVQ-ve vendoset nga Këshilli i qarku. Fondi për këtë shpërblim mbulohet nga buxheti i bashkisë.

### **Neni 19** **Detyrat e KQRVQ**

KQRVQ aktivizohet në rastin kur referendumi vendor do të zhvillohet në nivel qarku. KQRVQ kryen të njëjtat detyra dhe ka të njëjta përgjegjësi për organizimin dhe administrimin e referendumit si ato që janë përcaktuar në këtë ligj për KQRV-në. Plotësimi i tyre KQRVQ e realizon, për aq sa është e mundur dhe e nevojshme, nëpërmjet dhe në bashkëpunim me KQRV-të që janë të ngritura në bashkitë që bëjnë pjesë në qarkun përkatës.

### **Neni 20** **Trupi gjyqësor për çështje të referendumit vendor**

Jo më vonë se një muaj nga konstituimi i organeve të zgjedhura për qeverisjen vendore, trupat gjyqësore të Gjykatave Administrative të shkallës së parë, përzgjedhin me short:

a) Sekretarin e KQRV-se për të gjithë KQRV-të që ngrihen në bashkitë që janë nën juridiksionin e saj.

b) Sekretarët e KQRV-ve, jo më vonë se pesë ditë pas përzgjedhjes së tyre, përzgjedhin me short sekretarin e KQRVQ-së.

c) Trupin gjyqësor me 3 antarë, që do të gjykojë çështje që lidhen me referendumin vendor.

2. Jo më vonë se një muaj nga konstituimi i organeve të zgjedhura për qeverisjen vendore, trupa gjyqësore të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, përzgjedhin me short, trupin gjyqësor me tre antarë, që do të gjykojë çështje që lidhen me referendume vendore.

## **Neni 21**

### **Detyrat e Kryetarit të bashkisë dhe Këshillit bashkiak**

1. Kryetari i bashkisë dhe Këshilli bashkiak kanë për detyrë të lehtësojnë procesin e organizimit dhe administrimit të referendumit vendor nëpërmjet:

- a) krijimit të lehtësive fizike infrastrukturore për punë për KQRV-ne, nëpërmjet dhënies së mjediseve të nevojshme për punë, sigurimit të kancelarive dhe pajisjeve të tjera të nevojshme.
- b) mbështetjen me mjete transporti, sipas nevojave të paraqitura me parë,
- c) dhënien pa pagesë të mjediseve të nevojshme për trajnimin e komisionerëve dhe mbështetjen me bazën materiale për trajnim.
- d) miratimit dhe vënien në dispozicion, për nevojat materiale të referendumit, të një buxheti vjetor të nevojshëm.

## **Neni 22**

### **Komisioni qytetar për administrimin e procedurave të votimit**

1. Administrimi i procesit të votimit për referendumin vendor kryhet nën përgjegjësinë e Komisionit Qytetar të qendrës së votimit, KQQV-ja

2. KQQV-ja përbëhet nga 3 antarë. Antarët e këtij komisioni janë qytetarë që vetë ofrohen, vullnetar. Të drejtën për të qënë antarë në këtë komision e ka çdo banor, me të drejtë vote, i njësisë vendore ku do të zhvillohet referendumi vendor, i cili ka arsim të lartë, nuk ka qënë asnjëherë i dënuar dhe nuk është antar i ndonjë partie politike. Për formimin e KQQV-së, KQRV-ja, jo më vonë se tre dite nga dita e njoftimit publik për datën kur do të zhvillohet referendumi vendor, publikon thirrjen për të aplikuar për antarë të komisionit qytetar për qendrën e votimit.

Jo më vonë se 20 ditët përpara ditës së votimit për referendum, KQRV-ja shpall listën e qytetarëve që do angazhohen si komisionerë në qendrat e votimit.

Në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, KQRV-ja organizon trajnimin e qytetarëve që do të jenë antarë të KQQV-së.

## **Neni 23**

### **Administrimi i procesit të votimit për referendumin vendor**

Votimi për referendumin vendor bëhet me fletë votimi në qendrën e votimit. Numri i qendrave të votimit dhe vend ndodhja e tyre është e njëjtë me atë që është përdorur në zgjedhjet e fundit për organet e qeverisjes vendore.

## **Kreu III**

### **NISMA PËR REFERENDUM VENDOR**

## **Neni 24**

### **Subjektet që mund të iniciojnë një referendum vendor**

1. Të drejtën për të iniciuar kërkesën për një referendum vendor e kanë:

- a) jo më pak se 10 përqind e zgjedhesve të regjistruar në listën e zgjedhesve të njësisë vendore në të cilën kërkohet të zhvillohet referendumi vendor por, në çdo rast jo më pak se 300 dhe/ose jo më shumë se 3000 shtetas me të drejtë vote.
- b) kryetari i bashkisë
- c) kryetari i këshillit të qarkut
- d) 1/3 e anëtarëve të këshillit bashkiakë;
- g) 1/5 antareve të këshillit të qarkut;

## **Neni 25**

### **Njësia vendore ku mund të zhvillohet referendumi vendor**

1. Në vartësi të problemit dhe interesit për çështjen lokale që kërkohet të trajtohet në referendum, një referendum vendor mund të zhvillohet:

- a) në një qark të caktuar;

- b) në një bashki ose më shumë se një bashki të një qarku;
  - c) në një qytet ose më shumë se një qytet të një bashkie;
  - d) në një njësi administrative ose më shumë se një njësi administrative të një bashkie.
2. Referendumi vendor mund të zhvillohet për të njëjtën çështje ose problem lokal, si një proces i mbyllur referendar, në disa nga nëndarjet administrative, njësi administrative, lagje, qytete të një njësie të vetëqeverisjes vendore. Në këtë rast referendumi duhet të zhvillohet në të gjithë njësitë, në të njëjtën ditë.

#### **Neni 26**

##### **Objekti i një referendumi vendor**

1. Referendumi vendor mund të kërkohet vetëm për një çështje ose një problem lokal dhe që është brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore pëkatëse.
2. Mënyra e trajtimit në referendum vendor e çështjes/problemit lokal dhe rezultati i referendumit nuk duhet të sjellin asnjë pasojë në zhvillimin e çështjeve lokale dhe/ose në ecurinë dhe cilësinë e jetesës dhe bashkëjetës në njësitë e tjera vendore, në të cilat nuk zhvillohet referendumi.
3. Objekt i referendumit vendor nuk mund të jetë asnjë çështje ose problem për të cilin ka ndalim kushtetues.

#### **Neni 27**

##### **Shqyrtimi i kërkesës për referendum vendor**

1. Kërkesa për referendum vendor e hartuar nga një prej subjekteve të parashikuara nga ky ligj, i paraqitet KQRV-së / KQRVQ për shqyrtim paraprak.
    1. KQRV-ja shqyrton paraprakisht çdo kërkesë për referendum vendor dhe shpall, me vendim, plotësimin formal të kushteve për legjimitetin e subjektit që paraqit kërkesën.
    2. Kërkesën për referendum, të shoqëruar me vendim tij KQRV-ja e dërgon për shqyrtim gjyqësor për bazueshmërinë ligjore në Gjykatën Administrative të qarkut gjyqësore nën juridiksionin e të cilës ndodhet njëzia e vetëqeverisjes vendore ku kërkohet të zhvillohet referendumi vendor
  2. Në zbatim të vendimit përfundimtar të Gjykatës administrative për bëshmërinë ligjore të referendumit vendor, KQRV-ja:
    - a) në rastin kur kërkesa është paraqitur nga te zgjedhur vendor fillon përgatitjet për zhvillimin e procedurave për kryerjen e referendumit vendor, sipas parashikimeve të përcaktuara në këtë ligj.
    - b) në rastin kur kërkesa është paraqitur nga një grup qytetarësh, pajis këtë grup me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve.
  3. Grupi nismëtar organizon dhe realizon mbledhjen e nënshkrimeve të mbështetëse për referendumin vendor. Fleta tip për mbledhjen e nënshkrimeve hartohet nga KQRV-ja
  4. Pas grumbullimit të nënshkrimeve sipas përcaktimeve të dhëna në këtë ligj, grupi nismëtar i dorëzon ato tek KQRV-ja. KQRV-ja verifikon nënshkrimet e mbështetësve sipas procedurave të parashikuara në Kodin zgjedhor të R. Shqipërisë, për verifikimin e nënshkrimeve për zgjedhjet, brenda jo më shumë se 10 ditëve nga depozitimi i tyre dhe merr një nga vendimet e mëposhtme:
    - a) të fillohen procedurat për kryerjen e referendumit vendor;
    - b) të caktojë një afat kohor për plotësimin ose korigjimin e pasaktësive të konstatuara;
    - c) të refuzojë kërkesën për referendum vendor nëse grupi nismëtar nuk arrin të sigurojë numrin e parashikuar të mbështetësve.
- Në rast të mospërputhjeve të informacionit që përmbahet në fletët e nënshkrimeve gjatë procesit të verifikimit, KQRV-ja informon grupin nismëtar me qëllim që të rregullojë, përmirësojë ose korigjojë Listën, për një afat jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e kthimit të saj.
5. Pas ridedepozitimit të Listës së Rishikuar, KQRV-ja bën sërish verifikimet përkatëse dhe në rast se e gjen listën të rregullt, merr vendimin për fillimin e procedurave për kryerjen e referendumit vendor. Këtë vendim ja njofton kryetarit të bashkisë, Këshillit bashkiak dhe grupit nismëtar.
  6. Në çdo rast vendimi i KQRV-se duhet të jetë i arsyetuar.

7. Ndaj vendimit të KQRV-së lidhur me verifikimin e Fletëve të Nënshkrimeve apo refuzimit të kërkesës për referendum, kërkesit e referendumit kanë të drejtë të paraqesin ankim në Gjykatën Administrative të shkallës së parë, nën juridiksionin e të cilit ndodhet njesia vendore ku zhvillohet referendumi vendor. Gjykata e shqyrtton dhe vendos për kërkesën, brenda një periudhe jo më të gjatë se pesë ditë pune. Vendimi saj mund të apelohej në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se dy pas shpalljes së tij. Gjykata Administrative e Apelit shprehet, me vendim për ankimin, jo më vonë se pesë ditë pune nga data e regjistrimit të tij. Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nuk mund të bëhet rekurs në Gjykatën e lartë.

8. Pas përfundimit të procedurave të verifikimit të ligjëshmërisë së kërkesës për referendum vendor, KQRV-ja, brenda dy ditëve, bënë njoftimi publik për fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit vendor. Njoftimi bëhet në organet e medias lokale, të shkruar dhe elektronike.

9. Në njoftim KQRV-ja shpall edhe datën kur do të zhvillohet referendumi vendor. Në çdo rast kjo datë nuk mund të jetë më e afërt se 45 ditë nga dita e njoftimit të fillimit të procedurave për zhvillimin e referendumit vendor.

## **Neni 28**

### **Subjektet që mund të ushtrojnë të drejtën e votës në referendum**

1. Shtetasi shqiptar, që në ditën e zhvillimit të referendumit ka mbushur moshën 18 vjeç, ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e votës.

*(Opsion: E drejta për të votuar në një referendum vendor mund ta parashikohet për shtetasit që ditën e votimit kanë mbushur moshën 17 vjeç –Kjo kërkon ndryshim në Kushtetutë)*

2. Përfshihen nga e drejta e votës për referendum vendor shtetasit që ndodhen në kushtet që e parashikojnë këtë përfshim në Kushtetutën e Republikës dhe në Kodin Zgjedhor.

3. Shtetasi që ka të drejtën për të votuar, e ushtron këtë të drejtë vetëm në rastin kur referendumi zhvillohet në njësinë vendore të cilës i përket lista e zgjedhësve ku ai bënë pjesë.

4. Shtetasit që janë të regjistruar në listën e zgjedhësve të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku do të zhvillohet referendumi vendor dhe që për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se 6 muaj, që paraprind datën e shpalljes së referendumit vendor, nuk kanë qënë rezidentë në njësinë vendore përkatëse, hiqen nga lista e votuesve që kanë të drejtë të votojnë për referendumin vendor. Nga kjo listë hiqen edhe të gjithë shtetasit, emigrantë, me banim jashtë territorit të vendit.

5. Të drejtën e votës për referendum vendor e kanë dhe personat me shtetësi të jo shqiptare, të cilët rezultojnë të jenë rezidentë, pa ndërprerje për një periudhë jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj, në njësinë vendore në të cilën zhvillohet referendumi vendor. Ushtrimi i kësaj të drejte kërkon regjistrimin paraprak të tyre në listën e votuesve, mbështetur në një vendim gjyqësor të gjykatës së faktit. Ky regjistrim mund të bëhet edhe ditën e votimit. *(Kjo dispozitë kërkon ndryshim përkatës në Kushtetutë)*

## **Neni 29**

### **Zhvillimi i fushatës informuese referendare**

1. Secili prej subjekteve që gëzon sipas këtij ligji të drejtën për të iniciuar një referendum vendor, ka të drejtën për të zhvilluar fushatë informuese referendare.

2. Autoritetet që ky ligj i ngarkon me detyra për organizimin, administrimin dhe zhvillimin e referendumit duhet të:

a) garantojnë kushtet e nevojshme dhe të mos pengojnë zhvillimin e fushatës informuese dhe shpjeguese për referendumin. Zhvillimi i fushatës referendare, në çdo rast duhet të respektojë parimet dhe kërkesat e përgjithshme të parashikuara në dispozitat që rregullojnë fushatat, në legjislationin zgjedhor në fuqi.

b) garantojnë barazi në mundësitë për fushatë dhe komunikimi me publikun për përkrahësit dhe kundërshtarët e propozimit për referendum. Ato duhet të mbajnë qëndrim të pavaruar, veçanërisht në lidhje me:

(i) mënyrën e komunikimit, organizimit dhe zhvillimit të fushatës për referendum;

(ii) mbulimin mediatik

(iii) mbështetjen financiare të fushatës dhe organizuesve të saj, mbështetës dhe kundërshtarë të referendumit

(iv) të drejtën për të përdorur hapësirat publike

3. Në çdo rast kur autoritetet kompetente kërkojnë të zbatojnë kushte kufizuese për zhvillimin e fushatës informuese referendare, ato duhet të informojnë, me shkrim, KQRV-në/KQRVQ-në dhe subjektet e interesuara për arsyet e një kufizimi të tillë. Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar me argumentin dhe mbështetjen ligjore përkatëse, në të cilën duhet të shprehet qartë rasti që parashikohet ndalimi i kësaj të drejte në legjislacion. Subjektet e interesuara, të cilat preken nga kushtet kufizuese, i zbatojnë keto kushte deri sa për to nuk është shprehur me vendim KQRV-ja/KQRVQ-ja. KQRV-ja/KQRVQ-ja e shqyrton dhe vendos për kërkesën për kushte kufizuese jo më vonë se 3 dite nga paraqitja e saj. Vendimi i KQRV-së/KQRVQ-së nuk ankimohet.

4. Në rast se autoritetet kompetente me veprimet apo mosveprimet e tyre pengojnë zhvillimin e fushatës informuese referendare, ndaj tyre zbatohen sanksione sipas legjislacionit për kundërvajtjet administrative në fuqi, të cilët vendosen në bazë të shqyrtimit gjyqësor të ankesës përkatëse, në gjykatën administrative të qarkut përkatës, në të cilën bënë pjesë njësi vendore ku kryhet referendumi.

### **Neni 30**

#### **Financimi i organizimit dhe fushatës për referendum vendor**

1. Subjektet që përgjigjen për organizimin e referendumit vendor dhe që zhvillojnë fushatë për informimin për çështjen që trajtohet në një referendum vendor, në rastet kur përdorin fonde publike ose private sipas përcaktimeve të dhëna në këtë ligj, duhet të zbatojnë të njëjtat parime, kërkesa dhe rregulla si ato që parashikon legjislacioni zgjedhor për financimin e fushatave për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

2. Përdorimi i fondeve publike nga buxheti i shtetit dhe i fondeve nga buxheti i njësisë vendore për financimin e fushatës informuese referendare nuk lejohet. Në rast shkelje të këtij ndalimi ligjor, ndaj atyre që ofrojnë financim publik dhe përfituesve të tij, aplikohen sanksione për kundërvajtjet administrative dhe/ose vepër penale, që lidhen me keqpërdorimin e fondeve publike, sipas përcaktimeve të parashikuara në legjislacionit në fuqi.

3. Për fushatën e informimit për referendumin vendor mbështetësit dhe kundërshtarët e tij nuk mund të përdorin financimeve nga donatorë privat.

4. Shpenzimet për përgatitjen dhe mbledhjen e nënshkrimeve të mbështetësve të referendumit vendor, kur për të pranuar zhvillimin e tij ato janë të nevojshme, mbulohen nga inisiatorët e tij. Inisiatorët janë të detyruar të hartojnë plan buxhetin e nevojshme për keto shpenzime dhe t'ja paraqesin atë KQRV-së. Për mbulimin e këtij buxheti mund të përdoren edhe fonde që jepen nga donatorë private. Për keto KQRV-a është e detyruar të hap një llogari të dedikuar bankare, që behet publike jo më vonë se dy ditë nga data e vendimit për fillimin e procedurave për referendumin. Mbështetja financiare nga donator privatë pranohet vetëm në rastet kur ata plotësojnë kushtet e përcaktuara për financimin me fonde private të fushatave për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë ose zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Pavarësisht nga vlera, fondi që dhurohet për referendumin vendor, duhet të depozitohet në llogarinë bankare të hapur nga KQRV-ja. Në asnjë rast shuma e fondeve private që dhurohen nuk duhet të kalojë vlerën e parashikuar në plan buxhet. Kur të tillë fonde arrijnë vlerën e parashikuar në buxhet, KQRV-ja deklaron ndërprerjen e dhurimeve të metejshme nga donatorë privatë. Në përfundim të procesit të grumbullimit të firmave, grupi nismëtar harton raportin për shpenzimet e kryera dhe e dorëzon në KQRV-në. Pas kësaj Grupi nismëtar mbyll llogarinë bankare.

Kostot dhe shpenzimet për përgatitjen e fletëve tip për mbledhjen e nënshkrimeve përballohen nga buxheti i njësisë së qeverisjes vendore.

5. Për nevojat e fushatës informuese për referendumin vendor organet e qeverisjes vendore duhet të caktojnë hapsirë publike falas, në mënyrë të barabartë, për mbështetësit dhe kundërshtarët e referendumit

6. Media lokale, elektronike dhe e shkruar, duhet t`ju sigurojnë, në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë, kohë dhe vend të mjaftueshem për informimin publik, mbështetësve dhe kundërshtarëve të referendumit.

## **Kreu IV**

### **PROCEDURA E ZHVILLIMIT TË REFERENDUMIT VENDOR**

#### **Neni 31**

##### **Lista e votuesve për referendum vendor**

1. Brënda pesë ditëve pas shpalljes së fillimit të procedurave për zhvillimin e referendumit vendor, Zyra e gjendjes civile në njesine vendore perkatese, harton dhe publikon listën e shtetasve, banorë të njësisë administrative ku do të zhvillohet referendumi vendor dhe që kanë të drejtë të marrin pjesë në votimin për referendum. Hartimi i listës kryhet sipas po të njëjtave procedura dhe kushte si ato që parashikohen në Kodin Zgjedhor për hartimin e listës së zgjedhësve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Procedurat për korrigjimin e listës janë të njëjta me ata që parashikon Kodi zgjedhor. Respektimi i afateve kohore të parashikuara në këto dispozita të Kodit Zgjedhor duhet të plotësohet për aq sa është e mundur dhe e nevojshme. Në çdo rast lista përfundimare duhet të publikohet jo më vonë se 10 dite nga dita kur do të zhvillohet referendumi.

2. Zyra e gjendjes civile pajis KQRV-në me numrin e nevojshëm të listave të votuesve, të hartuara për çdo zonë zgjedhore, për çdo qendër votimi, jo më vonë se pesë ditë përpara ditës së votimit për referendum.

3. KQRV-ja i dergon KQQV-së listat e votuesve së bashku me materialet e tjera të nevojshme për procesin e votimit jo më vonë se 24 ore përpara hapjes së procesit të votimit.

#### **Neni 32**

##### **Votimi dhe nxjerrja e rezultatit**

1. Parimet, rregullat dhe procedurat që duhet të zbatohen gjatë procesit të votimit për referendum vendor janë të njëjta me procedurat e përcaktuara në Kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

2. Pas përfundimit dhe mbylljes së votimit, KQQV-ja, administron materialet e votimit, vlerëson dhe numron fletët e votimit të hedhura në kuti dhe nxjerr rezultatit. Materialet e qendrës së votimit, së bashku me procesverbalin e rezultatit, dorëzohen në KQRV.

3. KQRV-ja harton tabelën përmbledhëse të rezultateve për të gjithë qendrat e votimit, llogarit rezultatit përfundimtar dhe shpall, me vendim, rezultatit përfundimtar të referendumit vendor. Vendimi i KQRV mund të ankimohet në Gjykatën administrative të qarkut. Ankimi ndaj vendimit të Gjykatës administrative gjykohet nga trupa gjyqesore e Gjykatës Administrative të Apelit. Ndaj vendimit të kësaj trupe nuk mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Rezultati i një referendumi vendor pranohet vetëm kur në votim marr pjesë jo më pak se 50 përqind e votuesve të rregjistruar në listën e votuesve të njësisë vendore në të cilën kryhet referendumi. Fituese shpallet alternativa që merr më shumë se 50 përqind të votave të vlefshme të hedhura në kuti.

4. Në përfundim të të gjithë procedurave të parashikuara ne kete ligj, KQRV-ja njofton Këshillin bashkiak dhe Kryetarin e bashkisë për rezultatin e referendumit vendor.

### **Neni 33**

#### **Zbatimi i vendimit të referendumit vendor**

1. Në rastin e referendumeve vendore vendimmarrëse ose abroguese të një vendim të organeve të qeverisjes vendore, vendimi i marr me referendum është detyrues për t`u zbatuar.
2. Organet e qeverisjes vendore brënda jo më shumë se 30 ditë nga marrja e njoftimit per rezultatin e referendumit vendor, me vendim të tyre, hartojne dhe miratojne rregullimet e nevojshme për zbatimin e vendimit të marr me referendum. Afatet për plotësimin e këtij detyrimi kushtëzohet vetëm nga përputhshmëria e tyre me afatet e tjera procedurale të cilat janë të parashikuara nga legjislacioni që rregullon aktivitetin e organeve te qeverisjes vendore.
3. Organet e qeverisjes vendor në çdo rast, duhet të anullojnë çdo vendim të tyre i cili bie në kundërshtim me rezultatin e referendumeve.
4. Në çdo rast, organet e qeverisjes vendor duhet të njoftojnë publikisht qytetarët për vendimmarrjen e tyre në zbatimin të rezultatit të referendumit.
5. Në çdo rast kur organet e qeverisjes vendore nuk reagojnë ndaj vendimit të marr me referendum, ndaj përgjegjësve aplikohen penalitetet.

### **Neni 34**

#### **Penalite**

1. Mos zbatimi ose pengimi për zbatim i vendimit të marr me referendum vendor kur rezultati i referendumit është detyrues, përben shkelje të rendë në plotësimin e detyres dhe është shkak i mjaftueshëm për aplikimin e ligjit për kundravajtjet administrative, pasojë e të cilit mund të jetë:
  - a) propozimi për shkarkim nga detyra i kryetarit të këshillit bashkiak/ kryetarit të këshillit të qarkut
  - b) propozim për shkarkimin nga detyra i kryetarit të bashkisë.
  - c) heqjen e të drejtës për të kandiduar në pozicione publike të tjera vendimmarrëse, për një periudhë jo më pak se 10 vjetë.
2. Në raste të tilla KQRV-ja është institucioni qe ka detyrimin te beje kallximin penal ne Gjykatën administrative te qarkut per penguesin e zbatimit te vendimit te marr me referendum vendor.

### **Neni 35**

#### **Sanksione**

1. Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji apo shkelja e tyre përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 100000 lekë, me përjashtim të rasteve kur përbëjnë vepër penale.

### **Neni 36**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

## **RELACION SHPJEGUES**

### **i projektligjit “Për referendumet vendore”**

#### **I. Qëllimi i projektligjit dhe objektivat që synohen të arrihen**

Kushtetuta e Shqipërisë përcakton si një ndër të drejtat kushtetuese për qytetarët angazhimin dhe pjesëmarrjen e tyre në zgjidhjen e çështjeve ose problemeve lokale që shqetësojnë komunitetin ku ata jetojnë, përmes ushtrimit të të drejtës për zhvillimin e referendumeve vendore. Për ta realizuar këtë të drejtë është e nevojshme që të ndërtohen mekaniza efektiv legjislativ, mekanizma që të mundësojnë dhe lehtësojnë ndërmarrjen dhe realizimin e referendumeve vendor si inisiativa të qytetare ose si mekanizma që mund të përdorin të zgjedhurit vendorë në përpjekjet e tyre për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme të vetëqeverisjes vendore.

Deri sot ka patur disa nisma për referendume lokale, të cilat në asnjë rast nuk kanë arritur të realizohen. Analiza e këtyre nismave tregon se një ndër faktorët që nuk kanë ndikuar “miqësisht” në ecurinë e këtyre nismave është edhe kuadri ligjor. Kujdesi i ligjvënësit shqiptar për zhvillimin e një legjislacioni sa më efektiv për referendumet vendor ka munguar. Për herë të fundit për këtë legjislacion është punuar në kuadër të hartimit të Kodit zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, 2003 dhe, pas kësaj, megjithë mangësitë, pasaktësitë dhe deri edhe kundërshitë e tij me dispozitat kushtetuese, asgjë nuk ka ndryshuar.

Në Kodin zgjedhor të R.Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012, në nenin 185, Shfuqizime, përcaktohet se “Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në pikën 1 të këtij neni, pjesa e nëntë “Referendumet” e ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që kanë lidhje me të mbeten në fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për referendumet e përgjithshme dhe vendore....”

Në këtë situatë, Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, me mbështetjen e LëvizAlbania, dhe në bashkëpunim me organe të zgjedhura për qeverisjen vendore, me qytetarë të angazhuar në çështjet publike, me universitetet dhe me ekspertë profesionistë, ka hartuar projektligjin “Për referendumet vendore”.

Ky projektligj u krijon mundësinë reale zgjedhësve/qytetarëve, të iniciojnë dhe të zhvillojnë referendume për çështje ose probleme të qeverisjes lokale. Ai ju jep mundësi të zgjedhurve në organet e vetëqeverisjes vendore të konsultohen, nëpërmjet referendumit vendor, me qytetarë për mënyrën se si duhet të zgjidhen probleme të rëndësishme që lidhen me qeverisjen vendore.

Projekt ligji ka për qëllim të rregullojë, në mënyrë të detajuar, procesin dhe procedurat në bazë të të cilave do të ndërmerret dhe realizohen nisma për referendum. Projekt ligji është hartuar në përputhje me parimet kushtetuese dhe me Kodin e praktikave të mira për referendumet i Komisionit Europian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias).

#### **II. Argumentimi i projektligjit lidhur me përparësitë, problematikat, efektet e pritshme**

Projektligji “Për referendumet vendore” synon të realizojë një zgjidhje efektive të përcaktimeve kushtetuese sipas të cilave, qytetari/zgjedhës shqiptar, në përputhje me parimin e demokracisë së drejtëpërdrejtë, ka të drejtë të marr pjesë direkt në zgjidhjen e çështjeve ose problemeve lokale nëpërmjet referendumit lokal. Në këtë mënyrë qytetari dhe të zgjedhurve vendor ju krijohen kushte të përshtatshme ligjore dhe mundësi më të mira për të bërë më të efektshme dhe aktive demokracinë e drejtëpërdrejtë. Miratimi dhe zbatimi i këtij projekt ligji do t’ju jap qyteratëve/zgjedhës mundësinë të ndërmarrin inisiativa për referendum vendor sa herë që ata e gjejnë që, për zgjidhjen e një problemi ose çështje lokale duhet që vetë ata të shprehin. Ky projekt ligj është një zhvillim më shumë i kërkesës dhe frymës së legjislacionit që rregullon problemet e vetë qeverisjes vendore. Ai ju krijon një hapësirë më të madhe dhe më efektive të zgjedhurve vendore, duke zhvilluar dhe plotësuar më mirë procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrjen e komunitetit.

Qasja dhe zgjidhjet që propozon projekt ligji në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen për të realizuar një referendum vendor, mënyrat se si duhet të ndërtohet dhe të funksionojë trupa që do të administrojnë zhvillimin e nje referendumi, janë një risi dhe zhvillim i mëtejshme i legjislacionit tonë. Sipas këtij projek ligji referendumi vendor parashikohet të realizohet si një proces, me cikël të mbyllur, brënda njësisë vendore ku kërkohet të bëhet. Projekt ligji ka ndërtuar mekanizma të cilat bëjnë që përgjegjësitë, detyrimet dhe të drejtat për zhvillimin e referendumeve vendore të jenë të gjitha të qytetarëve. Në të njëjtën kohë ai parashikon përfshirjen e Gjykatës administrative të qarkut dhe Gjykatën administrative të Apelit, si institucione që do të gjykojnë dhe vendosin për bazueshmërinë ligjore të çështjes ose problemit lokal për të cilin kërkohet të zhvillohet referendumi vendor, ashtu sikurse edhe për trajtimin dhe gjykimin e ankimeve që efektivisht mund të bëhen.

Projektligji është i ndërtuar në respekt të standardet dhe praktikat më të mira evropiane, si dhe parimet e trashëgimisë elektorale evropiane, duke referuar frymën dhe praktikën e Rregullores Nr. 211/2011<sup>1</sup> të Parlamentit Evropian dhe të Kodit të Praktikave të Mira për Referendumet<sup>2</sup> (2007) të Komisionit të Venecias si dhe modeleve të ligjeve për referendume vendore të shteteve të tjera si Rumania, Mali i zi, Maqedonia, Ukraina, Kosova, Spanja, Mbretëria e Bashkuar.

Në këtë kuadër, pritet që miratimi i ligjit fillimisht, të rrisë iniciativat e qytetarëve për të ndërmarr referendume për çështje dhe /ose probleme të vetëqeverisjes lokale; miratimi dhe zbatimi i këtij ligji pritet të ndikojë në zhvillimin e mëtejshëm të kulturës dhe mendësinë për pjesëmarrje dhe angazhim civil, por edhe do të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për t'u përfshirë më shumë dhe në mënyrë më efektive në punët publike nëpërmjet nismave referendare. Ky kuadër ligjor do të shërbejë për zhvillimin e mëtejshëm të frymës së bashkëpunimit midis organeve të zgjedhura për vetëqeverisjen vendore dhe komunitetit.

### **III. Vlerësimi i ligjshmërisë, kushtetutshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin**

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e RSH si dhe me të gjithë legjislacionin shqiptar në fuqi. Gjithashtu, projektligji reflekton standardet dhe praktikat më të mira evropiane, si dhe parimet e trashëgimisë elektorale evropiane.

Kështu, nëse i referohemi Kushtetutës së RSH, e cila u miratua me referendum popullor në vitin 1998, në nenin 108, pika 4, përcaktohet se “*Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore*”. Në këtë kontekst projektligji përmbush një nga detyrimet e rëndësishme kushtetuese, atë të realizimit në praktikë, me rregulla të qarta procedurale, të të drejtës kushtetuese sipas të cilës, qytetarët mund të shprehin direkt për çështje ose probleme lokale nëpërmjet referendumit.

### **Vlerësimi i shkallës së përafritimit me *acquis communautaire***

Projektligji “Për referendume vendor” është hartuar në frymën dhe praktikën e Kodit të Praktikave të Mira për Referendumet (2007) të Komisionit të Venecias, Rregullores Nr. 211/2011 të Parlamentit Evropian dhe të disa modeleve të ligjeve për referendume vendore të shteteve të tjera si Rumania, Mali i zi, Maqedonia, Ukraina, Kosova, Spanja, Mbretëria e Bashkuar.

### **IV. Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektligjit**

Projektligji “Për referendume vendore” është i organizuar në katër Krerë

**Kreu i Parë** 'Dispozita të Përgjithshme' permban qëllimin e dhe objektin e ligjit, llojet e referendumeve vendore që mund të kryhen, plotësimin e sigurisë dhe besueshmërisë proceduarial, kufizimet dhe vlefshërinë e tekstit të nje referendumi vendor, parimet bazë për realizimin e procesit të këtyre referendumeve si dhe përkufizimet dhe terminologjinë e draftit të ri të propozuar.

**Kreu i Dytë** i dedikohet në detaje trajtimit të çështjeve që lidhen me autoritetet, institucionet dhe administrata që kanë detyrën për organizimin dhe administrimin e një referendumi vendor.

<sup>1</sup> Për më shumë, teksti i plotë i Rregullores 211/2011 gjendet në faqen e internetit <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=URISERV:ai0044>

<sup>2</sup> Për më shumë lexo [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2007\)008-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2007)008-e)

Dispozitat e këtij kreu parashikojnë procedurat që duhet të ndiqen për ngritjen e administratës që do të organizojë dhe administrojë procesin e një referendum vendor, cilësitë që duhet të zotrojnë qytetarët që vetëofrohen për të qënë pjesë e kësaj administrate, vendimmarrjen në komisionet që administrojnë procesin, detyrat që duhet të kryejnë autoritete që ligji i ngarkon për të qënë pjesë e zbatimit të procedurave të parashikuara për një referendum vendor.

**Kreu i Tretë** trajton çështjet që lidhen me nismën për referendum vendor. Në të përcaktohen subjekte që mund të propozojnë një referendum të tillë, njësitë vendore në të cilat mund të zhvillohet referendumi vendor, subjektet që mund të ushtrojnë të drejtën e votës në një referendum vendor, si dhe çështje që lidhen me fushatën për referendum dhe financimin e saj. Projekt ligji parashikon që të drejtën për të votuar në një referendum vendor duhet ta kenë vetëm zgjedhës me vendbanim rezidencial të përhershëm në njësinë vendore përkatëse dhe jo zgjedhës që banojnë jashtë territorit të kësaj njësie. Projekt ligji parashikon që të drejtën për të votuar ta kenë edhe shtetas jo shqiptar, rezidentë në njësinë vendore përkatëse, me shënimin që për këtë rast duhet të bëhet ndryshimi i nevojshëm në kushtetutë.

Projekt ligji e koncepton fushatën për referendumin vendor vetëm si një proces informues dhe sqarues për qytetarët. Ai i ngaron me detyrë organet e qeverisjes vendore për të lehtësuar këtë fushatë informimi nëpërmjet ofrimit pa pagesë të hapsirave publike, si dhe parashikon detyrimin për mediat lokale për të ofruar mundësi informimi me mjetet që ato zotrojnë, falas, si për mbështetësit ashtu edhe për kundërshtarët e referendumit. Ligji përfshijë mundësinë e përdorimit të fondeve publike ose private për nevojat e informimit publik për referendumin.

Në **Kreun e Katërt** janë zhvilluar procedurat që duhet të ndiqen për realizimin e një referendumi vendor. Tregohet se kush janë institucionet që shqyrtojnë kërkesën për referendum dhe si arrihet deri në vendimin përfundimtar për zhvillimin e një referendumi vendor. Jepen procedurat që duhet të ndiqen gjatë procesit të votimit dhe deri në nxjerrjen dhe publikimin e rezultatit përfundimtar. Në këtë kre janë përfshirë edhe dispozita në lidhje me detyrimin ligjor për zbatimin e rezultatit të një referendumi vendor si dhe penalitetet që duhet të zbatohet në rastet e shkeljeve të tyre.

#### **Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e ligjit**

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e ligjit janë:

- **Komisioni Qytetar për Referendumat Vendore** i cili regjistron kërkesën, miraton shpërndan dhe kontrollon Fletët e Mbledhjes së Nënshkrimeve, organizon dhe administron gjithë procesin për zhvillimin e referendumit
- **Këshillat Bashkiakë** që përgjigjen për organizimin dhe realizimin e procesit të zgjedhjes së antarëve të KQVR dhe që miratojnë mbeshetejn financiare për lehtësitë infrastrukturore të nevojshme për zhvillimin e referendumit vendor.
- **-Kryetar i bashkisë, keshilli bashkiak, kryetari dhe keshilli i qarkut** si nismëtarë të një referendumi vendor dhe që kanë detyra për krijimin kushteve të nevojshme për zhvillimin e tij.
- **Gjykatat Administrative** që vendosin për bazueshmërinë ligjore të kërkesës për referendum vendor, si dhe trajtojnë ankimet kundër vendimeve të KQVR .

#### **V. Shpenzimet buxhetore që lidhen me zhvillimin e një referendumi vendor**

Kostot për bazën materiale të nevojshme për një referendum vendor, mbulohen nga buxheti i njësisë vendore, bashkisë përkatëse.

Administrata, KQVR dhe komisionet qytetare që administrojnë procesin e mbledhjes së firmave mbështetëse, informimin e publikut dhe procesin e votimit angazhohen në bazë të parimit të vullnetarizmit.